# DËSHMI ARKIVI

**A-442008**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nis viti i ri shkollor, 25 mijë fëmijë në klasën e parë, 53 shkolla të reja. Shtohen masat për sigurinë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/nis-viti-i-ri-shkollor-25-mije-femije-ne-klasen-e-pare-53-shkolla-te-reja-shtohen-masat-per-sigurine/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 06:17:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 06:08:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 06:07:00 UTC → 14 shtator 2026, 06:09:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `776c278cc96c99b2ac59afce2d7b6d05935046b5884796750deed44b11230c2a` |
| TEKSTI | `a9697aa24603fe924a636c7428289f2216835b3bdbd9343ccc10226f65f393ca` |
| PAMJA | `b07640109b98da7cb7d2ae0fe1b633382e88b2fab81f4f46b8fa713df594a8f7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5a80acfc49fa705b757ce2b8a5fc3988a2c03d20ec3111769c1d9c9988c23c9b` |
| E MËPARSHMJA | `c9024180e8dabf6d5e722f523a6d4770d922ce0cf1adf49ddd0c23e11d384cb9` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5a80acfc49fa705b757ce2b8a5fc3988a2c03d20ec3111769c1d9c9988c23c9b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nis viti i ri shkollor, 25 mijë fëmijë në klasën e parë, 53 shkolla të reja. Shtohen masat për sigurinë

14/09/2026 08:08



**Viti i ri shkollor 2026–2027 ka nisur në të gjithë vendin, me mijëra nxënës që rikthehen në bankat e shkollës dhe rreth 25 mijë fëmijë që nisin për herë të parë klasën e parë.**

Viti i ri shkollor shoqërohet me një sërë masash dhe ndryshimesh në arsimin parauniversitar, me fokus te përmirësimi i infrastrukturës, forcimi i sigurisë në shkolla, zgjerimi i shërbimit psiko-social dhe krijimi i më shumë mundësive për aktivitete jashtë orarit mësimor.

Siç bën me dije Ministria e Arsimit, vitin shkollor 2026-2027, 53 shkolla të reja ose të rehabilituara hapin dyert për nxënësit. Gjatë vitit shkollor nxënësit do të kenë mundësi të angazhohen edhe në aktivitete të ndryshme akademike dhe krijuese, përfshirë festivalin e shkencës, olimpiadat, konkurset e gjuhës dhe aktivitetet muzikore.

Siguria është një nga elementet më delikate dhe nga prioritetet kryesore të këtij viti shkollor, e theksuar edhe nga ministrja Mirela Kumbaro në fjalën e saj përshëndetëse. Në institucionet arsimore në të gjithë vendin do të jenë në shërbim të nxënësve mbi 400 oficerë sigurie, të cilët do të veprojnë sipas protokolleve dhe standardeve të përditësuara.

Në kuadër të forcimit të masave të sigurisë, 20 shkolla në Tiranë janë përfshirë në projektin pilot "Smart City". Në këto shkolla parashikohet përdorimi i kamerave inteligjente, si pjesë e masave të shtuara për monitorimin dhe sigurinë e ambienteve shkollore.

Në shkollat e vendit do të jenë të pranishëm 900 psikologë dhe punonjës socialë, të cilët do të ofrojnë mbështetje për nxënësit dhe do t'u përgjigjen nevojave të tyre sociale dhe emocionale. Një nga risitë kryesore të këtij viti është zgjerimi i programit "Pas Shkolle".

Pas fazës pilot të zhvilluar në Tiranë gjatë vitit të kaluar, programi këtë vit shtrihet në 408 shkolla në të gjithë Shqipërinë. Në kuadër të programit do të zhvillohen klube dhe aktivitete në fusha të tilla si arti, muzika, teatri, sporti, zejet dhe aktivitete të tjera krijuese.

Nxënësit dhe prindërit do të informohen gjatë javëve të para të vitit shkollor për mënyrën e funksionimit të programit dhe për mundësitë e përzgjedhjes së aktiviteteve. Për zhvillimin e tyre është hapur edhe thirrja për trajnerë. Në këtë proces mund të përfshihen mësues, mësues në pension, artistë, artizanë dhe profesionistë të fushave përkatëse.

Të dhënat paraprake për vitin e ri shkollor tregojnë gjithashtu një lëvizje të nxënësve nga arsimi jo-publik drejt sistemit publik. Rreth 1,200 nxënës janë transferuar nga shkollat jo-publike në shkollat publike për këtë vit shkollor. Kjo lëvizje përbën një nga treguesit e ndryshimeve në strukturën e regjistrimeve për vitin 2026–2027.


## Kryesore



Tension te Zogu i Zi, protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre
09:38

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave
08:35

Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane
07:48

Rusia godet një tren në Ukrainë, pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarë të lartë europianë kaluan në të njëjtën linjë
07:12

Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e meritoj çmimin
07:58

## Më të lexuarat

"Dil jashtë"/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për 'Territorialen' në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debate në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Egla Cenos

Exclusive/ "Rastësia që më lidhi me Artur Zhejin", rrëfehet për herë të parë bashkëshortja e publicistit: Kam dashur vetëm ta ndjek dhe ta adhuroj

E ndoqi në hotel dhe u larguan së bashku nga klubi i natës, 17-vjeçarja gjermane shokon: Më duket se më përdhunoi një burrë 10 vite më i madh

Rama paralajmëron hapjen e 4 universiteteve të reja në vend, kryeministri zbulon qytetet që do të mirëpresin institucionet arsimore

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

Takimi në Berat për hartën e re territoriale, Rama: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit dhe këmbëngulja e disa zonjave të Dimalit i dhanë...

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

Përveç procesit mësimor, gjatë vitit të ri shkollor pritet të ketë një fokus më të madh edhe te zhvillimi i aktiviteteve jashtëshkollore. Nxënësit do të kenë mundësi të marrin pjesë në olimpiada, konkurse, aktivitete shkencore, kulturore dhe artistike, ndërsa programi "Pas Shkolle" synon të zgjerojë këto mundësi në 408 shkolla.

**Top Channel**

"Pengu për dy fëmijët që nuk erdhën kurrë", Soni Malaj rrëqeth me rrëfimin e saj në Grida Duma Podcast

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

## Aktualitet »



Ngecën në Qafë Mollë, dy turistë gjermanë humbin rrugën në terrenin malor pas Dajtit, ndërhyn Policia
14/09 11:28



Nis viti i ri shkollor, hapen dyert e shkollave në të gjithë Shqipërinë, 25 mijë fëmijë nisin sot udhëtimin arsimor
14/09 11:21



Dosja "Partizani"/ Shtyhet seanca për Berishën në GJKKO, avokatët bojkotojnë procesin
14/09 11:06



Ngriti alarm për bombë në shkollën "Edith Durham", shoqërohet personi që telefonoi policinë
14/09 10:38



Asociacioni i Gazetarëve Shqiptarë i drejtohet Kushtetueses, kërkon shfuqizimin e rregullores së GJKKO-së
14/09 10:16



Dënohet agjenti imobiliar në Angli, i siguroi shqiptarëve 9 shtëpi për të mbjellë kanabis me vlerë 2 milion stërlina
14/09 09:52

## Kryesore »



Takim në kryesinë e Kuvendit, Niko Peleshi pret të ngarkuarën me punë të SHBA-së Nancy VanHorn
14/09 11:25



Premier League pranon gabimin: Goli i Haaland ndaj Manchester United nuk duhej të ishte quajtur i rregullt
14/09 11:22



Nis viti i ri shkollor, hapen dyert e shkollave në të gjithë Shqipërinë, 25 mijë fëmijë nisin sot udhëtimin arsimor
14/09 11:21



Dosja "Partizani"/ Shtyhet seanca për Berishën në GJKKO, avokatët bojkotojnë procesin
14/09 11:06




Ambasada e SHBA-së paralajmëron protesta në Kosovë, udhëzim për shtetasit amerikanë në ditën e vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK
14/09 11:02



Ngriti alarm për bombë në shkollën "Edith Durham", shoqërohet personi që telefonoi policinë
14/09 10:38

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »







Top News- Tjetër arratisjeje e Alket Rizait/ Theu lejen e posaçme, Greqia e shpall në kërkim



Top News – 'Ca vile do shkosh sonte?', qytetarët përballen me Ballukun në ditën e 106 të protestës



Top Channel/ Tension te Zogu i Zi, protestuesit tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa



Top News- PDK kërkon masë të përkohshme/ Çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit



Top Channel/ "Mos i çoni fëmijët në shkollë", 106 ditë tubim, protestuesit paralajmërojnë bojkot



Top Channel/ Protesta do riorganizim. Thirrjet e qytetarëve në tubimin e 106-të: Të bashkohemi!



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.